

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8329
E premte, 26 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Të paktën 164 të vdekur nga tërmetet e fuqishme në Venezuelë | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

LV-ja PËLQEN KANDIDAT JOPARTIAK PËR PRESIDENT | FAQE 4-5



Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka dalë fituese e zgjedhjeve të 7 qershorit, ka bërë me dije se kandidati për president duhet të jetë jopartiak.

Zyrtarët e kësaj partie kanë theksuar se fillimisht presin certifikimin e rezultateve, më pas konstituimin e Kuvendit, formimin e qeverisë dhe

në fund zgjedhjen e presidentit. Ata kanë paralajmëruar se për këtë pozitë do të zhvillohen konsultime edhe me partitë opozitare

ANKETA WEBALKANS 2026: POLICIA E KOSOVËS DHE FSK-JA KRYESOJNË PËR BESIMIN E QYTETARËVE F. 3



AGIM VELIU: KËRKESAT PËR DORËHEQJEN E ABDIXHIKUT JANË PLOTËSISHT LEGJITIME F. 5



AKTUALE



'KËRCËNIM PËR SIGURINË': IKBALLE HUDUTIT I NDALOHET HYRJA PËR 15 VJET NË SHQIPËRI F. 6

HAXHIU: SERBIA MBAN PËRGJEGJËSI TË DREJTPËRDREJTË PËR HAPJEN E ARKIVAVE DHE ZBARDHJEN E FATIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR ME DHUNË F. 6

KOSOVA NUK FTOHET NË SAMITIN E NATO-s, MINISTERIA E JASHTME JEP ARSYET F. 3

EKONOMI



ÇITAKU: LV-ja KA KUNDËRSHTUAR ÇDO PROJEKT QË DO T'I SHIGURONTE KOSOVËS MË SHUMË PAVARËSI ENERGETIKE F. 8

MBI 1 500 ANKESA TË KONSUMATORËVE PËR GJASHTË MUAJ, PROBLEMET ME ENERJINË ELEKTRIKE NË KRYE TË LISTËS F. 7

SPORT



KOSOVA ME PARAQITJE POZITIVE NË MIQËSORET NDAJ ARABISË SAUDITE F. 24

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mobi: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TË PAKTËN 164 TË VDEKUR NGA TËRMETET E FUQISHME NË VENEZUELË

KARAKAS, 25 QERSHOR - Dy tërmete të fuqishme kanë lënë të vdekur të paktën 164 persona dhe kanë lënduar qindra të tjerë në Venezuelë, kanë njoftuar autoritetet e atjeshme, pasi dy dridhje të fuqishme shkaktuan rrëzimin e ndërtesave.

Punëtorët e shpëtimit dhe banorët janë parë duke kontrolluar nëpër rrënoja për të mbijetuar, teksa pas fatkeqësisë natyrore udhëheqësja e përkohshme e vendit, Delcy Rodríguez, shpalli gjendje emergjente.

Tërmetet me 7.2 dhe 7.5 shkallë të Rihterit goditën zonën e njëjtë në Venezuelë të mërkurën, sipas Shërbimit Gjeologjik të Shteteve të Bashkuara, duke shkaktuar rrëzimin e ndërtesave në kryeqytet dhe duke detyruar autoritetet që ta mbyllin aeroportin kryesor të vendit. Rodríguez kishte deklaruar



paraprakisht se 20 pasgoditje ishin regjistruar pas dy tërmeteve.

Lëkundjet e tokës shkaktuan panik në Karakas. "Shkallët u rrëzuan, i gjithë muri u çua. Gjërat binin nga tavani. Ishte e tmerrshme", tha për AFP-në, Odalis Escalona, 54-vjeçare. ShBA-ja "menjëherë disloko

ekipe të kërkim-shpëtimit, burime mjekësore dhe ndihmë humanitare për Venezuelën", tha sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio, të enjten.

Presidenti amerikan Donald Trump tha të mërkurën vonë se "dy tërmete të fuqishme sapo goditën popullin e Venezuelës dhe që të dy janë masivë dhe

kanë shkaktuar numër të tmerrshëm vdekjesh".

Tërmeti i parë, me epiqendër 21 kilometra në perëndim të qytetës Moron, ndodhi në orën 22:04, sipas kohë lokale, tha Shërbimi amerikan i Gjeologjisë. Brenda minutës, një tërmet prej 7.5 shkallësh goditi rreth 45 kilometra më larg. "Ky tërmet është ngjarja e dytë me tërmet të dyfishtë. Shkalla prej 7.5 ballësh ndodhi pas një goditje prej 7.2 shkallësh që zgjati 39 sekonda", tha shërbimi amerikan.

Të dy goditjet ishin në thellësi prej 22 kilometrash, përkatësisht 10 kilometrash.

Ministri i Brendshëm, Diosdado Cabello, u bëri thirrje banorëve që të largoheshin nga shtëpitë, duke shtuar se furnizimet me gaz të ndërtesave janë ndërprerë si masë mbrojtëse. Callebo tha se shtetet e Turijlos, Karabobos, Mirandas dhe La Guairas janë

goditur më së rëndi.

Aeroporti Ndërkombëtar Maiquetia, që gjendet afër Karakasit, u mbyll për shkak të "dëmeve serioze" në infrastrukturë, tha Rodríguez. Dridhjet e tokës u ndien deri në Bogota të Kolumbisë, ku u lëshuan alarmet dhe disa banorë u evakuuan nga ndërtesat si masë mbrojtëse.

Venezuela gjendet në një zonë që është e prirë të përballet me tërmete dhe lëkundjet më të mëdha të tokës në historinë moderne të Venezuelës ndodhën në verilindje të vendit në vitin 1997, kur vdiqën 73 persona dhe në Karakas më 1967, 236 persona humbën jetën.

Pak pas dridhjeve të dyfishta të tokës, një tërmet prej 7.2 ballësh goditi veriun e Japonisë, thanë autoritetet të cilat nuk raportuan për viktime apo dëme materiale.

'KËRCËNIM PËR SIGURINË': IKBALLE HUDUTIT I NDALOHET HYRJA PËR 15 VJET NË SHQIPËRI

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Shqipëria ia ka ndaluar të enjten hyrjen në vend për 15 vjet predikueses fetare nga Kosova, Ikballe Huduti, e njohur për qëndrimet e saj pro Iranit dhe kundër Shteteve të Bashkuara, duke e akuzuar si "kërcënim për sigurinë e vendit", pasi ajo ishte parë në protestat e këtij muaji në Tiranë.

Huduti mori pjesë në një prej protestave që po zhvillohen në kryeqytetin shqiptar tash e 25 ditë kundër ndërtimit të një resorti në një zonë të mbrojtur në jug të Shqipërisë, i cili lidhet me kompaninë e Jared Kushnerit, dhëndrit të presidentit amerikan, Donald Trump. Ajo e postoi në kanalën e vet në YouTube një video nga pjesëmarrja e saj në ditën e 15-të të protestës në Tiranë.

Në një reagim në "Facebook", kryeministri shqiptar, Edi Rama, e cilësoi Hudutin si një prej përfituesve të kësaj proteste, duke theksuar se ajo "predikon urrejtje, thërrret për kryengritje ndaj Qeverisë së Shqipërisë, kërkon hakmarrje ndaj Amerikës".

Burimet bënë me dije për Radio Evropa e Lirë se vendimi për t'i ndaluar hyrjen Hudutit është marrë pasi "veprimtaria e saj vlerësohet kërcënim për vendin, sigurinë kombëtare si dhe rendin e sigurinë publike".

Urdhri u nënshkrua nga ministri i Brendshëm, Besfort Lamallari, dhe u është përcjellë Policisë së Shtetit dhe strukturave të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për zbatim të

menjëherëshëm.

Rama shkroi se figura të tilla si Huduti "në emër të fesë predikojnë urrejtje, nxisin përplasje dhe përpiqen të shfrytëzojnë kauza mjedisore për qëllime politike dhe ideologjike". Ai publikoi fotografi ku Huduti shfaqej pranë ish-presidentit iranian Mahmoud Ahmadinejad.

Huduti është predikuese fetare nga Kosova, e njohur për përkatësinë e saj në komunitetin shiit. Ajo njihet për qëndrimet publike në mbështetje të figurave dhe politikave të Republikës Islamike të Iranit. Ajo ishte arrestuar më 2020 nga autoritetet e Kosovës pas publikimeve të saj në rrjetet sociale në mbështetje të gjeneralit iranian Qasem Soleimani, i cili ishte vrarë nga një sulm amerikan me dron në Irak atë vit. Ajo u akuzua për shtytjen e veprave terroriste në Kosovë, por u lirua më vonë nga akuzat në mungesë të provave.

Ndërkohë, ky është rasti i dytë në pak ditë që kryeministri Rama përmend pjesëmarrës në protestë për lidhje me Iranin. Dy ditë më parë, Dritan Goxhaj, i cili lexoi pesë kërkesat e protestuesve për qeverinë, u quajt nga Rama "zëdhënës i interesave të Iranit". Rama publikoi në "Facebook" pjesë nga postime të një llogarie që mban emrin dhe fotografinë e Goxhajt, ku janë publikuar postime me qëndrime të ashpra kundër politikave të Shteteve të Bashkuara dhe Izraelit në



Lindjen e Mesme, si dhe me tone mbështetëse ndaj Iranit dhe Hezbollahut, të cilin postim e përshkruan si "rezistencë të armatosur".

Hezbollah është grup militant dhe parti politike që kontrollojnë një pjesë të madhe të Libanit jugor. Ai konsiderohet organizatë terroriste nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa Bashkimi Evropian e ka futur në listën e zezë krahun e tij të armatosur. Rama i ka paraqitur protesta e tanishme kundër qeverisë së tij dhe ndërtimit të resortit në Zvërnec jo si revoltë spontane qytetare, por si të nxitur nga faktorë të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe nga dezinformimi. Ai ka folur për "luftë hibride", duke përmendur fillimisht ndikime nga Greqia

dhe Irani, më pas propagandë të shpërndarë nga blogerë dhe rrjete sociale, si edhe pjesëmarrje të personave nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut. Më 20 qershor, Rama tha se vëmendja ndërkombëtare për Zvërnecin nuk lidhet me mbrojtjen e natyrës, por me përfshirjen në projekt të Jared Kushnerit dhe lidhjen e tij familjare me presidentin amerikan, Donald Trump. Gjatë protestës më 21 qershor, një vajzë e hoqi flamurin izraelit në Ambasadën e Izraelit në Tiranë dhe e grisi atë gjatë kohës kur protestues të shumtë po marshonin në rrugët e kryeqytetit të Shqipërisë.

Protestat në Tiranë, Vlorë dhe qytete të tjera të Shqipërisë kundër punimeve për një resort

në zonën e mbrojtur Pishë Poronartë, në jugperëndim të Shqipërisë, mes shqetësimeve për ndikimin në mjedis dhe hetimeve për pronësinë e tokës, kanë hyrë në ditën e 24-të.

Prokuroria e Posaçme është duke kryer hetime në lidhje me kontratat e shitjes së tokës, ku do të realizohet ky projekt. Sipas të dhënave zyrtare, zona në Zvërnec figuron në pronësi të kompanisë Albania Land Development, e regjistruar më 27 maj 2025 në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.

Ndërkaq, të dhënat e Qendrës Kombëtare të Biznesit tregojnë se pronarë janë vëllezërit nga Katari, Mohamadmoataz Mhd Ruslan Alkhayat dhe Ramez Mhd Ruslan Alkhayat.

ANKETA WEBALKANS 2026: POLICIA E KOSOVËS DHE FSK-JA KRYESOJNË PËR BESIMIN E QYTETARËVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Policia e Kosovës ka mirëpritur rezultatet e anketës rajonale Webalkans 2026, sipas së cilës, 85.6 për qind e qytetarëve kanë shprehur besim në Policinë e Kosovës, duke e renditur atë si institucioni me nivelin më të lartë të besimit publik në Republikën e Kosovës së bashku me FSK-në me 87.4 për qind.

Ky rezultat përfaqëson një vlerësim të rëndësishëm për punën, profesionalizmin dhe përkushtimin e vazhdueshëm të zyrtarëve policorë të cilët çdo ditë janë në shërbim të qytetarëve për garantimin e rendit publik, sigurisë dhe sundimit të ligjit.

Besimi i qytetarëve është themeli i punës policore dhe një tregues i drejtpërdrejtë i partneritetit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe komunitetit. Ky besim është inkurajim për punë policore me përkushtim, në përmbushjen e misionit tonë kushtetues dhe ligjor në mbrojtje të jetës, pronës dhe

sigurisë së të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Rezultatet e anketës tregojnë gjithashtu se qytetarët vazhdojnë ta konsiderojnë sigurinë, sundimin e ligjit dhe luftimin e korrupsionit ndër prioritetet kryesore për zhvillimin e vendit. Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarve vlerësojnë se forcimi i zbatimit të ligjit dhe luftimi i korrupsionit duhet të mbeten në fokus të përpjekjeve institucionale, duke reflektuar pritjet e qytetarëve për institucione të fuqishme, profesionale dhe të përgjegjshme.

Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar në luftimin e të gjitha formave të kriminalitetit, përfshirë krimin e organizuar, korrupsionin, trafikimin dhe veprat e tjera penale që cenojnë sigurinë dhe mirëqenien e qytetarëve. Përmes përdorimit të praktikave bashkëkohore policore të policimit të udhëhequr nga inteligjenca dhe policimit në bashkësi, partneritetit me qytetarë, transparencës institucionale,



zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale dhe bashkëpunimit me institucionet vendore dhe partnerët ndërkombëtarë, ne do të vazhdojmë të forcojmë sundimin e ligjit dhe sigurinë

publike në vend.

Policia e Kosovës shpreh mirënjohje për besimin e treguar, për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme të qytetarëve, institucioneve vendore dhe

partnerëve ndërkombëtarë në përmbushjen e objektivave të përbashkëta si dhe do të vazhdojmë të punojmë me profesionalizëm, integritet dhe transparencë për garantimin e sigurisë dhe sundimit të ligjit.

KOSOVA NUK FTOHET NË SAMITIN E NATO-S, MINISTRIA E JASHTME JEP ARSYET

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës ka sqaruar lidhur me atë se Kosova nuk ka marrë ftesë për pjesëmarrje në Samitin e NATO-s që mbahet në Turqi. "Për të sqaruar keqkuptimet dhe pasaktësitë e ngritura nga disa portale, theksojmë se Republika e Kosovës nuk merr pjesë në Samitet e NATO-s në cilësinë e shtetit pjesëmarrës, pasi nuk është shtet anëtar i

Aleancës dhe aktualisht nuk është pjesë e Programit të Partneritetit për Paqe (Partnership for Peace - PfP). Samitet e NATO-s janë takime të krerëve të shteteve dhe qeverive të 32 vendeve anëtare të Aleancës. Në raste të veçanta, në varësi të agjendës së samitit, ftesë mund të marrin edhe partnerë të NATO-s. Në samitin që do të mbahet në Ankara, përveç vendeve anëtare, ftesë kanë



pranuar partnerët e NATO-s në kuadër të Indo-Pacific Four (IP4) - Japonia, Koreja e Jugut, Australia dhe Zelanda e Re - si

dhe Ukraina, në cilësinë e partnerit të NATO-s. Republika e Kosovës deri më tani nuk ka marrë pjesë në një Samit të NATO-s si shtet pjesëmarrës. Pjesëmarrja e Kosovës në të kaluarën ka qenë në kuadër të aktivitetit 'Women, Peace and Security' (Gratë, Paqja dhe Siguria), të organizuar nga Departamenti i Shtetit i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në margjinat e Samitit të NATO-

s. Ky aktivitet ishte një ngjarje e veçantë, e organizuar paralelisht me samitin, dhe nuk përbente pjesëmarrje në vetë Samitin e NATO-s", thuhet në këtë sqarim, duke shtuar se Republika e Kosovës mbetet e përkushtuar për thellimin e bashkëpunimit me NATO-n dhe shtetet anëtare të saj, si dhe për avancimin e aspiratës së saj strategjike për anëtarësim të plotë në Aleancë.

OFICERI I FSK-SË ZGJIDHET UDHËHEQËS I KLASËS NË KURSIN NDËRKOMBËTAR ME PJESËMARRËS NGA 20 SHTETE

Prishtinë, 25 qershor - Oficeri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, major Vilson Musaj, ka përfunduar me sukses kursin ndërkombëtar "International Military Cooperation Course (IMCC)", i cili është mbajtur në Mbretërinë e Holandës.

Kursi mblodhi pjesëmarrës nga 20 shtete të botës dhe shërbeu si një platformë e rëndësishme për shkëmbimin e përvojave profesionale, avancimin e njohurive dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e mbrojtjes dhe

sigurisë.

Gjatë zhvillimit të kursit, major Vilson Musaj u zgjodh udhëheqës i klasës, duke përfaqësuar të gjithë pjesëmarrësit në aktivitetet e programit.

Në ceremoninë e diplomimit majori mbajti fjalimin përmbyllës në emër të pjesëmarrësve të kursit. Pjesëmarrja aktive dhe arritjet e personelit të FSK-së në programe të tilla ndërkombëtare pasqyrojnë nivelin e lartë të

profionalizmit dhe përkushtimin për zhvillim të vazhdueshëm profesional, në funksion të forcimit të kapaciteteve mbrojtëse dhe bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë.

Ministria e Mbrojtjes mbetet e përkushtuar për ta mbështetur zhvillimin profesional të personelit ushtarak, duke investuar në ngritjen e kapaciteteve dhe përmbushjen e standardeve më të larta profesionale në shërbim të Republikës së Kosovës.





LV-ja PËLQEN KANDIDAT JOPARTIAK PËR PRESIDENT

Lëvizja Vetëvendosje, e cila ka dalë fituese e zgjedhjeve të 7 qershorit, ka bërë me dije se kandidati për president duhet të jetë jopartiak. Zyrarët e kësaj partie kanë theksuar se fillimisht presin certifikimin e rezultateve, më pas konstituimin e Kuvendit, formimin e qeverisë dhe në fund zgjedhjen e presidentit. Ata kanë paralajmëruar se për këtë pozitë do të zhvillohen konsultime edhe me partitë opozitare

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Anëtarja e kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Arbëria Nagavci, ka deklaruar se presin një kandidat konsensual për president, i cili do të ishte më unifikues dhe do të ushtronte me kompetencë e përgjegjësi pozicionin e presidentit. Ajo ka thënë se do të shmangin një krizë të re. "Ne presim që të kemi një kandidat ose kandidat konsensuale. Jopartiak. Emra të cilët do të ushtronin, besoj edhe me kompetencë e përgjegjësi, pozicionin e tyre dhe rolin unifikues po ashtu. Pra, të gjenden disa emra konsensualë, sepse besoj se Kosova ka mjaftueshëm njerëz me integritet, të cilët do të ushtronin në mënyrë shumë të mirë postin e presidentit apo presidentes", ka thënë Nagavci. Ajo ka pohuar se është koha që të mendojnë të

gjithë se si të dalin nga kjo krizë politike. "Të lëmë anash vetëm ambiciet edhe interesat personale", është shprehur Hagavci. Ndërkaq ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka deklaruar se po presin certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve të 7 qershorit për t'i filluar takimet me partitë politike për çështjen e presidentit. "Le të presim njëherë që të ndodhë certifikimi i rezultateve dhe pastaj pas certifikimit të rezultateve natyrisht që do të ketë takime me partitë politike dhe urojmë që ta gjejmë një konsensus në mënyrë që ta votojë Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesëvjeçar dhe të vazhdojnë punët dhe përgjegjësitë që i kemi para qytetarëve", ka thënë ajo, duke shtuar se njëherë presin konstituimin e Kuvendit dhe pastaj formimin e qeverisë e tek pastaj zgjedhja e presidentit. "Ta konstituojmë

Kuvendin, ta zgjedhim qeverinë dhe menjëherë pra, pas konstituimit të Kuvendit, kryetari i ri i Kuvendit ose kryetarja, kushdo që të jetë ai apo ajo, do të ketë të drejtën kushtetuese ta mandatojë kandidatin për kryeministër të vendit", është shprehur Haxhiu. E pyetur nëse do të jetë kandidate për presidente, Haxhiu është përgjigjur shkurt. "Jo, nuk do të jem kandidate për presidente".

Haziri: Vjosa Osmani, i vetmi emër i LDK-së për president

Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se kjo parti nuk ka ndryshuar qëndrim. "Nominimi për presidente i Vjosa Osmanit mbetet i vetmi emër nga radhët e LDK-së. Në kuadër të debatit paszgjedhor, në emër të LDK-së kam paraqitur parimet gjithëpërfshirëse dhe modalitetet për bashkëpunim të mundshëm, për krijimin e stabilitetit politik dhe institucional. Kryetari Lumir Abdixhiku mbetet adresa e vetme për zhvillimin e proceseve politike në të ardhmen e afërt. Kërkesat politike, ndërkaq, çfarëdo natyre qofshin, do të trajtohen brenda strukturave legale të LDK-së. Demokracia është e barasvlefshme me lirinë dhe

pavarësinë e Republikës. Kauza 'një parti, një shtet' është kauzë e humbur. Askush mbi Republikën!", ka shkruar Haziri në "Facebook". Ish-kryetari i AAK-së dhe ish-kryeministri Ramush Haradinaj ka thënë se opozita nuk ka arritur të krijojë një marrëveshje të përbashkët politike dhe një kandidat të përbashkët, duke vlerësuar se në këto rrethana vendi do të vazhdojë të udhëhiqet nga agjenda e Lëvizjes Vetëvendosje dhe e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti. Haradinaj ka theksuar se vetëm një bashkim i opozitës, me një kontratë të qartë politike dhe me një kandidat të përbashkët për president, mund ta ndryshojë situatën aktuale politike në vend. "Ne po jetojmë në epokën Kurti, që i bie se ai, kur i ka 40 % ose mbi 40 deputetë, do ta zbatojë agjendën e vet në Kosovë. Ndikimi ynë, ose ne do të mund të mos jetonim vetëm në epokën e tij, por edhe në epokën e të tjerëve, sikur të kishim një kontratë të përbashkët si opozitë. Pra, AAK-ja, LDK-ja dhe PDK-ja, edhe një plan konkret, një kandidat konkret", është shprehur Haradinaj. Sipas tij, mungesa e një alternative të organizuar opozitare po i jep mundësi Kurtit t'i vazhdojë politikën e tij dhe ta çojë vendin sërish në zgjedhje. "Përderisa

nuk kemi një kontratë dhe nuk kemi një ofertë, ne jetojmë në epokën Kurti, në agjendën Kurti dhe ai do ta zbatojë atë që di më së miri, një lloj eksperimentimi me Kosovën, dhe do të na dërgojë në zgjedhje prapë. Pra, kjo është ajo që di dhe ajo që po ndodh. Nga përvoja ime e gjatë politike, unë po e lexoj këtë", ka thënë ai. Haradinaj ka folur edhe për mundësinë e zgjedhjes së presidentit, duke thënë se opozita mund të bëhet faktor vendimtar nëse arrin një marrëveshje të përbashkët. "Opozita mundet, pra të hyjë dhe të jetë faktor në marrjen e fatit të vendit në dorë, duke pasur një kontratë mes vete dhe një kandidat për president. Nëse dikush nga opozita e merr mbështetjen e opozitës, gjithsesi që do ta mbështesja. Nëse do të isha i propozuar (për president), do ta shqyrtoja. Pra, nuk jam kandidat, nuk kam kushte, nuk kam kërkesë për askënd. Ne nuk bëhemi pjesë e qeverisjes ose e vazhdimit të qeverisjes Kurti, sepse e kemi shpjeguar disa herë sa e dëmshme dhe sa humbje është për Kosovën. Po e them edhe një herë, përderisa LV-ja nuk bie nën 40 %, do të jetojmë në epokën Kurti, në agjendën Kurti, në eksperimentin Kurti. Mund ta pengojmë këtë, mund ta ndryshojmë vetëm nëse

AGIM VELIU: KËRKESAT PËR DORËHEQJEN E ABDIXHIKUT JANË PLOTËSISHT LEGJITIME

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ish-ministri i LDK-së dhe ish-deputeti Agim Veliu ka thënë se kërkesat për dorëheqjen e Lumir Abdixhikut janë plotësisht legjitime dhe të drejta. Sipas tij, ato burojnë nga fakti se ai mori përsipër meritat për çdo sukses të pretenduar, prandaj thotë se duhet të marrë përsipër edhe përgjegjësinë për dështimin. “Nën drejtimin e tij, LDK-ja mbeti e ngujuar në vendin e tretë, pa arritur të rikthehet si alternativë serioze për pushtet, pavarësisht premtimeve të mëdha dhe kontrollit të plotë mbi partinë. Pas disa cikleve zgjedhore pa rezultatet e premtuara, qëndrimi në krye të partisë pa reflektim politik shihet si mungesë përgjegjësie dhe pengesë për reformimin e LDK-së. Edhe më shqetësues ishte reagimi arrogant i Abdixhikut ndaj kryetarëve të Lipjanit, Pejës dhe një dege të

kryeqytetit, të cilët kërkuar dorëheqjen e tij”, ka shkruar Veliu në “Facebook”. Veliu ka thënë se në vend se të reflektonte mbi kritikën, Abdixhiku reagoi duke kërkuar dorëheqjen e dy kryetarëve të degëve që kanë fituar vazhdimisht zgjedhjet në komunat e tyre, ndërsa vetë refuzon të japë llogari për rezultatet e partisë në nivel qendror. “Duke u sjellë si pronar partie e jo si kryetar i zgjedhur, Abdixhiku po dërgon mesazhin se në LDK ndëshkohen ata që kërkojnë llogaridhënie, jo ata që dështojnë. Kur një lider kërkon të heshtë kritikët, të ndëshkojë fituesit dhe të mbrojë veten nga përgjegjësia politike, problemi nuk është më vetëm rezultati i zgjedhor. Problemi është mënyra se si ai e kupton demokracinë, debatin e brendshëm dhe vetë funksionimin e partisë”, ka shkruar Veliu.



MZHR DHE MAPL NËNSHKRUAJNË NISMËN PËR THEMELIMIN E SHSTATË QENDRAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL NË KOSOVË



PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) kanë nënshkruar të enjten nismën për themelimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në shtatë rajonet zhvillimore të Kosovës. Marrëveshja është nënshkruar nga ministri në detyrë i MZHR-së, Rasim Demiri, dhe ministri në detyrë i MAPL-së, Elbert Krasniqi, dhe synon forcimin e bashkëpunimit ndërkomunal si dhe zhvillimin e balancuar rajonal në vend. Sipas njoftimit, kjo nismë ka për qëllim rritjen e

efikasitetit të investimeve publike dhe koordinimin më të mirë të politikave zhvillimore në nivel rajonal. “Qendrat për Zhvillim Rajonal do të shërbejnë si mekanizma për koordinimin e politikave zhvillimore, identifikimin e prioritetëve rajonale dhe promovimin e investimeve që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së jetesës së qytetarëve”, thuhet në njoftim. Përmes këtyre qendrave synohet krijimi i një mjedisi më të favorshëm për zhvillim ekonomik, rritje të

bashkëpunimit institucional dhe shfrytëzimit më efikas të potencialeve rajonale. Nga institucionet përkatëse është theksuar se kjo nismë përbën një hap të rëndësishëm drejt zhvillimit të qëndrueshëm rajonal dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve në të gjitha komunat e vendit. Sipas tyre, Qendrat për Zhvillim Rajonal do të mundësojnë koordinim më të mirë ndërmjet nivelit lokal dhe atij qendror, me fokus në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve të Kosovës.

Malaj pas takimit me Hargreavesin: Kosova ka nevojë urgjente për krijimin e institucioneve të reja

Prishtinë, 25 qershor - Ambasadori i Shqipërisë në Kosovë, Petrit Malaj, ka zhvilluar një takim me ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar në Kosovë, Jonathan Hargreaves, të cilin e ka vlerësuar mjaft të rëndësishëm dhe konstruktiv. Sipas Malajt, gjatë bisedës është diskutuar për forcimin e marrëdhënieve ndërmjet Shqipërisë dhe

Mbretërisë së Bashkuar si dhe për situatën aktuale politike në Kosovë. Ai ka bërë me dije se të dy diplomatët kanë ndarë qëndrime të ngjashme lidhur me rëndësinë e krijimit sa më të shpejtë të institucioneve të reja demokratike në vend, me qëllim vazhdimin e reformave dhe avancimin e proceseve që ndikojnë në mirëqenien e

qytetarëve. “Ndamë të njëjtin vlerësim mbi nevojën urgjente për krijimin e institucioneve të reja demokratike, në mënyrë që të vijojë avancimi i reformave të rëndësishme për prosperitetin e qytetarëve të Kosovës dhe për të ardhmen e rinisë së saj të talentuar, energjike dhe plot potencial”, ka shkruar Malaj në rrjetet sociale.



bëhemi bashkë ne, opozita”, ka thënë Haradinaj. Kryeministri në detyrë, Albin Kurti, ka deklaruar të mërkurën se Kosova nuk kishte nevojë për zgjedhje të reja dhe, sipas tij, ky rezultat e dëshmon këtë, të cilën e kishte ripërsëritur, para se ato të ndodhnin. “Sido që të jetë, qytetarët folën sërish qartë. Rezultati duhet të pranohet e respektohet dhe vullneti i popullit të zbatohet e të përkthehet në institucione

funkionale e demokratike, të angazhuara e të përkushtuara për zhvillim e mirëqenie, arsim e shëndetësi, për siguri e mbrojtje, industri e prodhim, investime të mëdha infrastruktururore nga hekurudhat te digat e jo vetëm. Andaj, porsa të certifikohet rezultati i zgjedhjeve, do ta nisim punën dhe diskutimet për formimin e institucioneve të reja: konstituimin e legjislaturës së njëmbëdhjetë

të Kuvendit, formimin e qeverisë së re dhe zgjedhjen e presidentit apo presidentes”, ka theksuar Kurti. Ndërkaq profesori i së Drejtës Kushtetuese, Mazllum Baraliu, ka vlerësuar se zgjedhja e presidentit apo presidentes së Kosovës duhet të jetë prioritet pas konstituimit të Kuvendit, më pas të formohet qeveria. Ai ka paralajmëruar se moszgjedhja e kreut të shtetit brenda afatit kushtetues prej

60 ditësh do ta çonte vendin në zgjedhje të reja. Kosova ka mbajtur zgjedhjet e treta parlamentare brenda një viti e gjysmë dhe tani duhet ta zgjedhë presidentin e ri. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) planifikon që certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve parlamentare të 7 qershorit ta bëjë deri më 6 korrik. Sipas Kushtetutës së vendit, seanca konstituive e

Kuvendit duhet të mbahet brenda 30 ditëve nga data e shpalljes zyrtare të rezultateve të zgjedhjeve. Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 53 ulëse, Partia Demokratike e Kosovës 22, Lidhja Demokratike e Kosovës 18 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 7. Njëzet ulëse janë të garantuara për komunitetet pakicë - dhjetë për serbët, dhjetë për të tjerat.

Kryesuesi i KGJK-së, Rrustem Thaqi, takon përfaqësuesen e OSBE-së, diskutojnë forcimin e bashkëpunimit

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), Rrustem Thaqi, ka pritur të enjten në takim ushtruesen e detyrës së shufes së Seksionit për Sundimin e Ligjit dhe Drejtësinë në kuadër të Organizatës për Siguri dhe

Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Pascale Langlais. Takimi është zhvilluar në kuadër të bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe OSBE-së, me fokus diskutimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe mundësive

për mbështetje të mëtejme institucionale. Kryesuesi Thaqi ka falënderuar OSBE-në për kontributin dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj sistemit gjyqësor, duke shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit në realizimin e objektivave të

përbashkëta. Gjatë takimit bashkëbiseduesit kanë diskutuar mundësitë për thellimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e iniciativave të përbashkëta në funksion të forcimit të sistemit gjyqësor dhe sundimit të ligjit në Kosovë.



HAXHIU: SERBIA MBAN PËRGJEGJËSI TË DREJTPËRDREJTË PËR HAPJEN E ARKIVAVE DHE ZBARDHJEN E FATIT TË PERSONAVE TË ZHDUKUR ME DHUNË

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, mori pjesë të enjten në përmblylljen e projektit "Na Mungojnë", i cili përmes dokumentarëve dhe debateve publike ka sjellë në vëmendje rrëfimet e familjeve të personave të zhdukur me dhunë dhe kërkesën e tyre të pandërprerë për të ditur. Kryetarja e Kuvendit tha se rrëfimet e familjeve nuk mbyllen bashkë me projektin, por mbesin edhe pasi fiket ekрани dhe mbaron debati. "Mbesin në shtëpitë ku prej vitesh përsëritet e njëjta pyetje: si ta kuptosh që njeriu yt zhduket me dhunë gjatë luftës dhe familja mbetet pa asnjë përgjigje?", tha Haxhiu. Sipas saj, zhdukja me dhunë e këput këtë fill të kuptimit, duke shtuar tutje se nuk ka shpjegim që e bën më të lehtë prirjen e një familjeje, as fjalë që e zëvendëson njeriun që mungon. "Por pamundësia për të kuptuar nuk e heq detyrimin për të ditur. Primo Levi ka shkruar se, kur të kuptosh është e pamundur, të dish bëhet e domosdoshme. Për

familjet e personave të zhdukur me dhunë, kjo është kërkesa e vetme, ta dinë ku janë më të dashurit e tyre", theksoi Haxhiu. Sipas saj, përgjigje nuk ka ngaqë Serbia ende i mban të mbyllura arkivat e saj ushtarake, policore dhe shtetërore, ndaj në këtë proces Serbia mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë. Ajo tha se në ato arkiva mund të gjenden të dhëna për urdhra, varrime, zhvarrime dhe vendndodhje që familjet i presin prej më shumë se një çerek shekulli. "Varrezat masive të zbuluara në territorin e Serbisë e kanë bërë të qartë se fshehja e gjurmëve ka qenë e qëllimshme. Hapja e arkivave nuk mund të mbetet çështje e vullnetit të Beogradit. Partnerët ndërkombëtarë duhet ta trajtojnë këtë si detyrim të qartë të Serbisë ndaj familjeve, ndaj drejtësisë dhe ndaj së vërtetës. Rreth 1600 persona ende janë në listat e të zhdukurve me dhunë, dhe shpeshherë përmenden si numra dhe si statistika. Por dokumentarët e tillë shkojnë përtej statistikave duke na dhënë emrat, fytyrat, dhe rrëfimet për ta



përmes zërave që kanë pritur shumë gjatë", tha më tej Haxhiu. Ajo shtoi se nga Drenasi në Mitrovicë, nga Peja në Prizren, nga Gjilani në Ferizaj, nga Gjakova në Prishtinë, këto rrëfime na kujtojnë se mungesa mund të mos jetë e njëjtë në çdo shtëpi, por prirja dhe kërkesa është e njëjtë. Sipas kryetares Haxhiu, kërkesa për të ditur nuk mund të mbetet vetëm në kujtesën e familjeve, por ajo, sipas saj kërkon punë të përditshme institucionale: hetim, dokumentim, punë mjekoligjore, bashkëpunim me

familjet dhe ndjekje të çdo informacioni që mund të çojë te e vërteta. "Dua të falënderoj Institutin e Mjekësisë Ligjore, Komisionin Qeveritar, Prokurorinë Speciale, Policinë dhe partnerët ndërkombëtarë për punën në gjetjen e personave të zhdukur me dhunë dhe në adresimin e krimeve të luftës. Vitet e fundit ka pasur përparim, falë rritjes së kapaciteteve dhe ndryshimeve ligjore që kanë mundësuar gjykimin në mungesë, si përgjigje ndaj mosbashkëpunimit të Serbisë. Institucionet e Republikës së Kosovës mbeten të përkushtuara ta mbështesin këtë punë, sepse drejtësia për krimet e luftës mbetet detyrim i pashmangshëm", u shpreh Haxhiu. Ajo tutje tha se në këtë drejtim Kosova ka bërë hapa të rëndësishëm duke e vendosur këtë çështje edhe në kuadër ligjor e institucional. "Në korrik 2023 Kosova iu bashkua Komisionit Ndërkombëtar për Personat të Zhdukur, ICMP. Në gusht 2023 u themelua Instituti

për Krimet e Kryera gjatë Luftës, ndërsa Strategjia për Drejtësi Tranzicionale 2024-2034 e vendos kërkimin e të vërtetës, drejtësinë, reparacionet dhe reformën institucionale si shtylla të kësaj fushe. Kjo punë ka sjellë edhe përgjigje konkrete. Identifikimi i personave të zhdukur nga masakra e Kralanit dhe rivarrimi i tyre pas kaq shumë vitesh na e kujton se asnjë rast nuk është i mbyllur përderisa familja nuk ka marrë përgjigje", theksoi Haxhiu. Ajo falënderoi BIRN Kosovën, ACDC-në, Bashkimin Evropian dhe të gjithë ata që kanë punuar në këtë projekt, duke shtuar më tej se falënderimi më i veçantë u takon familjeve që kanë pranuar të flasin. "Ato nuk kanë folur për ta kthyer dhimbjen në rrëfim publik, por sepse e dinë se e vërteta duhet të ketë edhe zë edhe dëshmitarë. Personat e zhdukur me dhunë janë emra që i përkasin kujtesës së këtij vendi dhe përgjegjësisë së institucioneve të tij. Derisa të ketë përgjigje për ta, kjo punë nuk mund të quhet e kryer", theksoi Haxhiu.

KURTI MORI PJESË NË TAKIMIN NDERUES ME RASTIN E 90-VJETORIT TË LINDJES SË PROFESORIT QOSJA

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Kryeministri në detyrë Albin Kurti mori pjesë në takimin nderues, të organizuar nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani", me rastin e 90-vjetorit të lindjes së profesorit Rexhep Qosja. "Një djalosh nga Vuthaj që vjen në Prishtinë dhe ndërton, për më shumë se gjysmë shekulli, një monument kulturor, i cili do të mbetet dëshmi kombëtare

shqiptare për të gjitha kohët. Ky ishte dhe do të mbetet përgjithmonë, profesor Rexhep Qosja", kështu e nisi fjalën kryeministri në detyrë, Kurti. Ai theksoi se profesor Qosja në historinë e letërsisë mbetet një nga studiuesit më të shquar, në letërsinë artistike një nga shkrimtarët më të rëndësishëm, në publicistikë një nga zërat më të fuqishëm, ndërkaq në mendimin



politik një nga intelektualët më të guximshëm. "Profesor Qosja thekson se një popull nuk mund ta ndërtojë të ardhmen duke harruar historinë e vet. Kujtesa historike nuk ishte kthim prapa, por kusht për ecjen përpara. Prandaj, ai mbeti një nga përcuesit më të rëndësishëm të Porosisë së Madhe, asaj ideje që rilindësit shqiptarë ua lanë brezave pasardhës si amanet

kombëtar", tha kryeministri. Në fund të fjalës, kryeministri në detyrë Kurti tha se përderisa do të ketë lexues të veprës së tij, studiues të mendimit të tij dhe shqiptarë, të cilët do të mundohen ta kuptojnë më mirë veten dhe kohën e tyre, do të vazhdojë të jetojë edhe Rexhep Qosja, si një nga figurat më përfaqësuese të kulturës shqiptare të shekujve XX dhe XXI.

Kryetari i AKB-së takon presidentin e Shqipërisë në 100-vjetorin e Prefekturës së Tiranës

TIRANË, 25 QERSHOR - Në kuadër të shënimit të 100-vjetorit të themelimit të Prefekturës së Tiranës, kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka takuar presidentin e Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj dhe kryetarin e Prefekturës së Tiranës, Shkëlqim Hajdarin. Gjatë takimit u diskutua për

thellimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, krijimin e mundësive të reja për bizneset, si dhe për nevojën e forcimit dhe zhvillimit të institucioneve të Kosovës në funksion të integritimit ekonomik dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Kryetari i AKB-së, Agim Shahini, theksoi se Aleanca Kosovare e Bizneseve mbetet e përkushtuar

për të mbështetur çdo iniciativë që kontribuon në zhvillimin e ekonomisë kombëtare dhe në forcimin e bashkëpunimit ekonomik mbarëshqiptar. "AKB është e gatshme të kontribuojë dhe të mbështesë çdo nismë që ndihmon zhvillimin ekonomik, rritjen e investimeve, krijimin e vendeve të reja të punës dhe avancimin e

bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë", ka thënë Shahini. Shënimi i 100-vjetorit të Prefekturës së Tiranës shërbeu si një mundësi e rëndësishme për takime institucionale, shkëmbim idesh dhe forcim të lidhjeve ndërmjet përfaqësuesve institucionale dhe ekonomike nga të gjitha trojet shqiptare.



98 inspektime në mbarë Kosovën: Mbyllen tri qendra masazhi dhe shqiptohen pesë gjoba

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, ka njoftuar se Inspektorati Qendror i Mbikëqyrjes së Tregut (IQMT), në bashkëpunim me Policinë e Kosovës dhe Inspektoratin Qendror të Punës, ditët e fundit

ka realizuar 98 inspektime të përbashkëta në qendrat e masazhit dhe lokalet e muzikës në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Si rezultat i mungesës së dokumentacionit të nevojshëm dhe mosrespektimit të orarit të punës, janë

mbyllur tri qendra masazhi, prej të cilave dy në komunën e Gjakovës dhe një në komunën e Rahovecit. Po ashtu, IQMT ka shqiptuar pesë gjoba ndaj subjekteve që nuk kanë paraqitur dokumentacionin e kërkuar gjatë procesit të inspektimit.

Me qëllim të garantimit të ushtrimit të ligjshëm të veprimtarive ekonomike dhe respektimit të legjislacionit në fuqi, IQMT, në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, do ta vazhdojë organizimin e aksioneve të përbashkëta inspektuese në të gjithë vendin.



MBI 1 500 ANKESA TË KONSUMATORËVE NË GJASHTË MUAJ, PROBLEMET ME ENERGJINË ELEKTRIKE NË KRYE TË LISTËS

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorit në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit (MINTI) ka trajtuar gjithsej 1 567 ankesa të konsumatorëve gjatë periudhës gjashtëmujore janar-qershor 2026. Sipas raportit të Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorit (DMK), numri më i madh i ankesave ka të

bëjë me problemet që lidhen me keqlllogaritjet e orës në njehsorët elektrikë, garancionin dhe kthimin e mallit, mospërputhjen e çmimeve raft-arkë nëpër markete, me blerjet online dhe mosdorëzimin e produkteve sipas përshkrimit të ofruar. Volumi i lartë i ankesave nga konsumatorët tregon se në një numër të konsiderueshëm rastesh operatorët ekonomikë nuk po i respektojnë në



mënyrë të plotë dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe të drejtat e garantuara të qytetarëve si konsumatorë.

Për këtë arsye, MINTI e konsideron të domosdoshme rritjen e mbikëqyrjes së tregut dhe ndërmarrjen e masave shtesë për ngritjen e nivelit të respektimit të të drejtave të konsumatorëve në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Ankesat e pranura janë trajtuar në bashkëpunim me institucionet kompetente, përfshirë Inspektoratin Qendror të Mbikëqyrjes së

Tregut (IQMT), Agjencinë e Ushqimit dhe Veterinarisë të Kosovës (AUVK), Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), Zyrën e Rregullatorit për Energji (ZRRE), Bankën Qendrore të Kosovës (BQK) dhe Autoritetin Rregullator të Shërbimeve të Ujit (ARRU), sipas kompetencave përkatëse.

UP-JA MIRATON DHE PARAQET STRATEGJINË E RE PESËVJEÇARE PËR ZHVILLIMIN E UNIVERSITETIT

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Universiteti i Prishtinës ka paraqitur zyrtarisht Planin Strategjik 2026-2030 pas miratimit të tij nga Këshilli Drejtues i UP-së. Me këtë rast është mbajtur një punëtori dhe prezantim zyrtar me pjesëmarrjen e menaxhmentit të universitetit, përfaqësuesve të Këshillit Drejtues, personelit akademik dhe administrativ, studentëve si dhe partnerëve zhvillimorë. Në fjalën e tij, rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Arben Hajrullahu, theksoi rëndësinë e planifikimit strategjik si bazë për zhvillimin afatgjatë të institucionit, duke nënvizuar veçanërisht nevojën për përgjegjësi institucionale në fazën e zbatimit. Ai theksoi se suksesi i strategjisë varet nga operacionalizimi i saj përmes planeve të mirëstrukturuara të veprimit, të përshtatura dhe të zbatueshme, të cilat sigurojnë përkthimin e objektivave strategjike në rezultate konkrete. Kryesuesja e Këshillit Drejtues të UP-së, Arberesha Nela-Turjaka, vlerësoi procesin gjithëpërfshirës të hartimit të strategjisë, duke theksuar se dokumenti



përfaqëson një vizion të përbashkët institucional dhe një udhërrëfyes të qartë për modernizimin, ndërkombëtarizimin dhe ngritjen e cilësisë në të gjitha fushat e funksionimit të universitetit. Ajo nënvizoi përgjegjësinë institucionale për garantimin e zbatimit të strategjisë dhe harmonizimin e planeve operative me objektivat strategjike dhe mundësitë buxhetore. Në këtë ngjarje, përfaqësuesi i

projektit SHER, Aqim Emurli, përgëzoi Universitetin e Prishtinës për këtë arritje të rëndësishme, duke theksuar se strategjia përfaqëson një udhërrëfyes drejt një universiteti modern, konkurrues dhe të orientuar drejt standardeve evropiane. Ai theksoi se SHER-i ka kontribuar në proces me anë të ekspertizës teknike, punëtorive, konsultimeve dhe mbështetjes së grupeve punuese, duke siguruar qasje gjithëpërfshirëse me

pjesëmarrjen e menaxhmentit, personelit dhe studentëve. Projekti SHER, i financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim dhe i bashkëfinancuar nga MASH-i dhe i zbatuar nga WUS Austria, Zentrum für Soziale Innovation (ZSI) dhe OeAD, ka mbështetur Universitetin e Prishtinës në dizajnimin e politikave të rëndësishme të cilat kanë rrjedhur nga Statuti i ri i Universitetit. Plani Strategjik 2026-2030 i UP-

së fokusohet në gjashtë fusha kryesore: ekselencia akademike, përvoja studentore, kërkimi dhe inovacioni, ndërkombëtarizimi, qeverisja dhe qëndrueshmëria, si dhe transformimi digital. Ngjarja u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt konsolidimit të vizionit të Universitetit të Prishtinës për një institucion modern, cilësor dhe të integruar në hapësirën evropiane të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

Policia e Kosovës dhe ARBK nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për forcimin e koordinimit institucional



Prishtinë, 25 qershor - Policia e Kosovës dhe Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK) kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me synim

forcimin e koordinimit ndërinstitucional dhe avancimin e bashkëpunimit në fusha me interes të përbashkët. Sipas njoftimit, marrëveshja parasheh

përmirësimin e shkëmbimit të informatave ndërmjet dy institucioneve, ngritjen e kapaciteteve profesionale si dhe zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit institucional.

Ky bashkëpunim synon ta rrisë efikasitetin në punë dhe të kontribuojë në ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët dhe bizneset në Kosovë.

ZKA dhe UNDP diskutojnë për forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit

Prishtinë, 25 qershor - Zëvendësauditori i përgjithshëm Bezad Halilaj, ndihmësauditorja e përgjithshme Myrvete Gashi-Morina, drejtoresha e Departamentit për Çështje Juridike dhe Kundër Mashtrimeve, Minire Begaj-Balaj si dhe Udhëheqësja e Njësisë Kundër Mashtrimeve, Natyra Kasumaj-Ahmeti, pritën në takim përfaqësueset e Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP), Marta K. Gazideda,

udhëheqëse e Portofolit për Qeverisje të Mirë dhe Paqe dhe zëvendësekoordinatore e Programit, si dhe Fjolla Raif-Luzha, menaxhere e projektit. Takimi pati për qëllim diskutimin e aktivitetëve të planifikuara në kuadër të projektit “Luftimi i Korrupsionit dhe Krimin Financiar” me fokus në ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit të ZKA-së përmes trajnimeve dhe programeve të certifikimit profesional në fushën e auditimit, çështjeve juridike

dhe identifikimit të mashtrimeve. Palët u pajtuan për avancimin e aktivitetëve të planifikuara në kuadër të projektit, me theks të veçantë në zbatimin e programit të certifikimit profesional. Po ashtu, gjatë takimit u diskutuan edhe mundësitë e bashkëpunimit dhe mbështetjes në të ardhmen, veçanërisht në fushën e digjitalizimit dhe zhvillimit të mëtejshëm të kapaciteteve institucionale të ZKA-së.



ÇITAKU: LV-ja KA KUNDËRSHTUAR ÇDO PROJEKT QË DO T’I SIGURONTE KOSOVËS MË SHUMË PAVARËSI ENERGETIKE

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Sekretarja e përgjithshme e PDK-së, Vlora Çitaku, ka deklaruar se debati për gazin amerikan nuk duhet të shihet si një çështje teknike apo energjetike, por si një çështje e sigurisë kombëtare dhe e orientimit strategjik të Kosovës. Përmes një postimi në “Facebook”, Çitaku tha se Kosova po përballet me një nga momentet më të rëndësishme strategjike që nga shpallja e pavarësisë, duke theksuar se në botën e sotme siguria energjetike është pjesë e pandashme e sigurisë shtetërore. Sipas saj, pavarësia energjetike është e lidhur ngushtë me aftësinë e shtetit për t’u përballur me krizat dhe për ta garantuar mirëqenien e qytetarëve.

Ajo theksoi se projekti i gazit amerikan nuk ka të bëjë vetëm me energjinë, por edhe me sigurinë, ekonominë, diplomacinë dhe partneritetin strategjik të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “Debati për gazin amerikan nuk është debat për një projekt teknik. Nuk është debat për një tubacion apo për një central energjetik. Ky është debat për sigurinë kombëtare të Kosovës. Kosova po përballet me një nga momentet më të rëndësishme



strategjike që nga shpallja e pavarësisë. Në një botë ku siguria energjetike po bëhet po aq e rëndësishme sa siguria ushtarake, vendimet që marrim sot do të përcaktojnë jo vetëm mirëqenien e qytetarëve tanë, por edhe pozitën e Kosovës në hartën gjeopolitike të dekadave që vijnë. Në botën e sotme, e cila po ndryshon vazhdimisht, pavarësia energjetike është pjesë e pavarësisë shtetërore. Luftërat moderne nuk zhvillohen vetëm me tanke dhe armë. Ato zhvillohen me

energji, me zinxhirë furnizimi, me kontroll mbi burimet strategjike dhe me aftësinë e një shteti për t’i mbrojtur qytetarët e vet nga krizat. Prandaj, kur flasim për gazin amerikan, ne nuk flasim vetëm për energji. Ne flasim për siguri. Për ekonomi. Për diplomaci. Për partneritet strategjik. Për të ardhmen e Kosovës”, ka shkruar ajo. Çitaku kritikoi Lëvizjen Vetëvendosje, duke e akuzuar se për vite me radhë ka kundërshtuar projekte që, sipas saj, do t’i siguronin Kosovës më

shumë pavarësi energjetike. Ajo vlerësoi se pasojat e kësaj politike po reflektohen në rritjen e kostos së energjisë, shtimin e importeve dhe vështirësitë me të cilat po përballet familjet dhe bizneset. “Fatkeqësisht, për vite me radhë, Lëvizja Vetëvendosje ka kundërshtuar pothuajse çdo projekt që do t’i siguronte Kosovës më shumë pavarësi energjetike. Fillimisht si opozitë, e më pas si qeveri. E shpeshherë edhe përmes formave të dhunshme. Sot po e shohim

rezultatit e kësaj politike. Kosova po paguan energjinë më shtrenjtë se kurrë më parë. Importet e energjisë po rriten nga viti në vit. Bizneset po dëmtohen. Familjet po përballet me fatura gjithnjë e më të larta dhe gjithnjë e më të papërbalueshme”, ka thënë Çitaku. Sipas saj, të gjitha vendet e rajonit po ndërtojnë lidhje të reja energjetike, po diversifikojnë furnizimin dhe po forcojnë sigurinë e tyre, ndërsa vetëm Kosova ka mbetur jashtë. Në fund ajo ka theksuar se partneriteti me SHBA-në nuk duhet të mbetet vetëm në nivel deklarativ, por të reflektohet përmes vendimeve dhe projekteve konkrete, duke shtuar se “koha e izolimit duhet të marrë fund” dhe se Kosova duhet të jetë pjesë e projekteve strategjike të Perëndimit. “Vetëm Kosova vazhdon të refuzojë një mundësi që aleati ynë më i madh strategjik, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e ka mbështetur vazhdimisht. Partneriteti me SHBA-në nuk matet vetëm me deklarata. Ai matet me vendime konkrete. Me projekte konkrete. Koha e izolimit duhet të marrë fund. Kosova duhet të jetë pjesë e projekteve strategjike të Perëndimit, jo spektatore e tyre”, ka thënë Çitaku.

KEK-u nënshkruan kontratë mbi 265 mijë euro për modernizimin e Termocentralit Kosova B

Prishtinë, 25 qershor - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar dhënien e kontratës për realizimin e punëve që kanë të bëjnë me demontimin, furnizimin, montimin, lëshimin në punë dhe komisionimin e sistemit të monitorimit të vibrimeve, zgjatjeve diferenciale, zhvendosjeve aksiale dhe zhvendosjes absolute në Bllokun B1 dhe B2 të Termocentralit Kosova B. Sipas

njoftimit zyrtar, vlera e përgjithshme e kontratës është 265 712.40 euro, ndërsa në procesin e tenderimit kanë marrë pjesë tre operatorë ekonomikë. Kontrata i është dhënë grupit të operatorëve ekonomikë Bionics Sh.PK. dhe TURBOCOM d.o.o., me adresë në Prishtinë. Data e dhënies së kontratës është 17 qershor 2026, ndërsa nënshkrimi i saj është planifikuar për 24 qershor 2026.

Sipas dokumentit, kontrata nuk parashihet të nënkontraktohet. Projekti synon avancimin e sistemit të monitorimit dhe kontrollit të pajisjeve në njësitë prodhuese të Termocentralit Kosova B, duke kontribuar në rritjen e sigurisë dhe efikasitetit operacional të tyre. Njoftimi është publikuar nga KEK-u në përputhje me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.



ZËRAT NGA IRANI: NA THONË SE FITUAM, POR NE S'KEMI PARA PËR BUKË



“Më dhemb ta shoh qytetin tim kështu”, thotë Shirin, e cila është kthyer prej një muaji pasi ishte strehuar me familjen në një fshat rreth 500 kilometra larg. “Gjatë bombardimeve u larguam”, shton ajo.

Shirin punon si fizioterapiste, por klinika e saj ende nuk është hapur. “Njerëzit nuk kanë para as për të paguar qiranë, jo më për fizioterapi”.

Për memorandumun mes Shteteve të Bashkuara dhe Republikës Islamike ajo di pak. Shirin është kundër luftës dhe kundër regjimit të Mojtaba Khameneit, por mendja i shkon te faturat dhe shpenzimet e muajit.

Në Teheran, Jasmine i ndjek negociatat nga redaksia ku punon. Ajo nuk e ka ndërprerë punën as gjatë sulmeve. Është kryeredaktore në një nga gazetaret më të mëdha të vendit dhe zakonisht janë gazetarët që e kontaktojnë atë. Këtë herë është ajo që pyet: Çfarë dini për bisedimet?

Sipas saj, propaganda është bërë edhe më e fortë. “Pasdaranët (Garda Revolucionare) përgatisin vetë materialet dhe ua dërgojnë redaksive. Artikuj, tituj, analiza. Drejtoret i marrin dhe ne duhet të ndërhyjmë sa më pak. Është gjithnjë e më e vështirë të

kuptosh çfarë është gënjeshtëri dhe çfarë është e vërtetë”, thotë ajo.

Në gazetën e saj, memorandumun paraqitet si një “frymëmarje”, por në shumicën e mediave të tjera cilësohet si një “fitore totale”. “Shkruajnë se kemi mposhtur SHBA-të, se jemi bërë të pathyeshëm”, tregon Jasmine.

Ajo dërgon një artikull nga gazeta pranë regjimit, Kayhan, ku analisti Hossein Shariatmadari pretendon se Bahreini është pjesë e territorit iranian dhe se populli i tij pret të bashkohet me “atdheun mëmë”.

Në televizion flitet për Bahreinin, Azerbajxhanin, Gjeorgjinë dhe Emiratet si vende që duhet të rikthehen nën ndikimin e Teheranit. “Kemi urdhër të tregojmë një Iran të fortë”, thotë Jasmine.

Ajo shton se në mbledhje “festojnë edhe deklaratat e Sánchez”, të cilat regjimi i interpreton si provë se Europa ka frikë nga Irani.

Ndërkohë, në tregje njerëzit përballen me një realitet krejt tjetër. Çmimi i qepëve është rritur me 41%, mishi i kuq me 157%, orizi iranian me 161%, ndërsa orizi i importuar mbi 220%. Pula është shtrenjtuar me 287%, vezët me 342% dhe vaji i gatimit me 431%.

“Po blejmë më pak nga gjithçka”, thotë Shirin. Për të, memorandumun është vetëm një fjalë që dëgjohej në radio, ndërsa ajo sheh listën e shpenzimeve që duhet të paguajë.

Edhe Samira, që jeton në Teheran, tregon të njëjtën histori. Për të problemi nuk është Libani apo programi bërthamor, por dentisti i djalit dhe kësti i ardhshëm i makinës.

“Nuk i besoj as Donald Trump-it, as Khameneit”, thotë ajo. “Disa shpresojnë se kjo marrëveshje do ta përmirësojë ekonominë, por regjimi nuk mendon për njerëzit e vet”.

Ajo kujton protestat e dhjetorit dhe janarit. “U vranë mijëra njerëz. Paratë do t'i përdorin për armatim dhe për të financuar milicët, jo për familjet që nuk kanë më shpresë”.

Më pas tregon historinë e djalit të një fqinje, i arrestuar një muaj më parë. “Nëna e tij shkon çdo ditë para burgut për të marrë lajme”. Ajo ka frikë se emri i tij mund të jetë në listën e të dënuarve me vdekje, e cila që prej fillimit të janarit ka kaluar shifrën 700.

Ali, i cili shkruan nga një qytet tjetër, nuk ka shumë shpresa. Thotë se marrëveshje të tilla i ka parë edhe më parë, se paratë do të përfundojnë në buxhetet ushtarake dhe se gjithçka mund

të anulohet në çdo moment.

Edhe Jasmine mendon njësoj. Ajo përipiqet ta shkruajë këtë herë pas here, por për një artikull tashmë është nën proces gjyqësor. “Të vërtetën përipiqem ta fus mes rreshtave dhe kjo është gjithmonë një rrezik shumë i madh”, thotë ajo.

Teksa ndjek negociatat në Lucernë, mendja i kthehet dimrit të kaluar. “Iranianët, më shumë se luftën, kanë brenda vetes masakrën e janarit. Për shumë prej nesh ky memorandum është një tradhti, është varri ynë. Perëndimi nuk e kupton se kush janë vërtet ajatollahët dhe çfarë do të thotë të jetosh nën sundimin e tyre”.

Irani për të cilin flet Jasmine është një vend me një popullsi të re, që dëshiron një jetë të lirë.

Më shumë se gjysma e 92 milionë

banorëve janë nën moshën 35 vjeç. Mbi 24 milionë janë të mitur, ndërsa të rinjtë nga 15 deri në 34 vjeç përbëjnë pothuajse 40% të shoqërisë.

Sipas saj, shumica e tyre duan vetëm të punojnë, të udhëtojnë, të flasin pa frikë dhe të mos e shohin jetën e tyre të vendosur nga lufta apo nga urdhrat fetarë. Kur pyetet se sa mbështetje ka ende regjimi i ajatollahëve, Jasmine përgjigjet me shifra. Sipas saj, rreth 5-6 milionë njerëz lidhen me administratën dhe aparatit e kontrollit, ndërsa 5-6 milionë të tjerë me Gardën Revolucionare, ushtrinë, policinë dhe forcat basij.

Pastaj janë edhe të varfrit, të cilët sipas saj dërgohen me autobusë në protesta në këmbim të ushqimit ose parave.

DANIMARKA MIRATON VENDOSJEN E MISIONIT NË NGUSHTICËN E HORMUZIT

Parlamenti danez miratoi të enjten vendosjen e kontributeve në një mision shumëkombësh në Ngushticën e Hormuzit, sipas mediave vendase.

Ligjvënësit vendosën që Danimarka do të dërgojë oficerë, përkthyes dhe dronë në rajon si pjesë e një misioni shumëkombësh të udhëhequr nga Mbretëria e Bashkuar dhe Franca që synon mbrojtjen e lirisë së lundrimit në ngushticë, si dhe operacionin detar të BE-së. Kontributi përbëhet nga një element oficeri shtabi, një kapacitet droni dhe një njësi përkthyes me gjithsej rreth 10 persona. Aftësitë kibernetike mund të përfshihen gjithashtu në përpjekjet ushtarake daneze. Që kur SHBA-të dhe Izraeli nisën sulmet ajrore ndaj Iranit në fund të shkurtit, rajoni ka mbetur i tensionuar, duke çuar në hakmarrje iraniane kundër



Izraelit dhe vendeve të tjera rajonale që strehojnë asete amerikane.

Irani dhe SHBA-të arritën një marrëveshje prej 14 pikash të ndërmjetësuar nga Pakistani, e cila hyri në fuqi më 18 qershor pasi u nënshkrua elektronikisht nga Presidenti iranian Masoud Pezeshkian dhe Presidenti i SHBA-së Donald Trump.

Marrëveshja përfshin dispozita që lidhen me përfundimin e luftës, duke përfshirë atë në Liban, rihapjen e Ngushticës së Hormuzit dhe heqjen e bllokadës detare amerikane të vendosur ndaj Iranit.

Trump komenton luftën në Ukrainë: Zelensky po ia del mbanë kundër rusëve!

Presidenti i SHBA, donald Trump tha të mërkurën se Volodymyr Zelensky po shkon “mjaft mirë”, duke iu referuar luftës Rusi-Ukrainë.


“Ai po reziston”, tha presidenti amerikan, duke iu referuar homologut të tij ukrainas në konferencën për shtyp në Shtëpinë e Bardhë. Javën e kaluar, në samitin e G7 në Evian të Francës, presidenti amerikan duket se



bëri një kthesë të papritur në favor të Kievit.

Republikani, i cili vazhdon të thotë se ka një marrëdhënie

të mirë me homologun e tij rus Vladimir Putin, pati një diskutim të gjatë me Presidentin ukrainas Zelensky dhe Presidentin francez Emmanuel Macron. Ky i fundit e përshkroi G7-ën si një “sukses”, veçanërisht për “Ukrainën”, duke pretenduar se kishte një “ndryshim shumë themelor në qasje” nga homologu amerikan i Trump.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE 'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Lorik Dobratiqi, lojtar i ri i Ballkanit

SUHAREKË, 25 QERSHOR - Ballkani ka njoftuar zyrtarisht transferimin e sulmuesit anësor Lorik Dobratiqi, i cili vjen si lojtar i lirë pas përfundimit të kontratës me Prishtinën e Re. "FC Ballkani

ka kënaqësinë ta paraqesë sulmuesin anësor Lorik Dobratiqi, i cili ka nënshkruar kontratë trevjeçare me ekipin tonë dhe do të jetë pjesë e klubit deri në verën e vitit 2029. Dobratiqi luan në

krahun e majtë të sulmit. Pritet ta shtoj konkurrencën, por dhe cilësinë në repartin ofensiv të ekipit tonë! Mirë se vjen në familjen e madhe të FC Ballkanit, Lorik!", ka njoftuar Ballkani.

Tri herë kampionët e Kosovës para disa ditësh kanë konfirmuar edhe transferimin e mesfushorit Edvin Kuç, i cili ishte kapiten dhe një nga lojtarët më të rëndësishëm në epokën e artë të Ballkanit.



KOSOVA ME PARAQITJE POZITIVE NË MIQËSORET NDAJ ARABISË SAUDITE



STAMBOLL, 25 QERSHOR - Kombëtarja e Kosovës në basketboll ka zhvilluar dy ndeshje miqësore ndaj Arabisë Saudite të cilat janë luajtur në Stamboll të Turqisë. Këto përballje i kanë shërbyer përgjedhësit Bujar Loci dhe

shtabit teknik për ta vlerësuar formën e lojtarëve para dy sfidave të rëndësishme ndaj Shqipërisë dhe Sllovakisë. Në ndeshjen e parë, "Dardanët" kanë pësuar humbje me rezultat 88:84, edhe pse për një pjesë të madhe të takimit

ishin në epërsi. Ndërsa në përballjen e dytë, Kosova është rikthyer me një fitore bindëse, duke triumfuar 91:71. Në përgjithësi, paraqitja e Kosovës është vlerësuar pozitive, me ekipin që po përgatitet për sfidat e

ardhshme. Kosova më 2 korrik në Prizren do të përballlet me Shqipërinë, ndërsa tri ditë më vonë do të udhëtojë drejt Sllovakisë. Këto ndeshje janë të vlefshme për parakualifikimet e FIBA Euro Basket 2029.


SHTATË KOMBËTARE ELIMINOHEN NGA KUPA E BOTËS 2026

NJU-JORK, 25 QERSHOR - Shtatë kombëtare kanë humbur matematikisht shanset për të vazhduar më tej në Kupën e Botës 2026, edhe pse ndeshjet e fundit të fazës së grupeve ende nuk kanë përfunduar. Nga 48 ekipet pjesëmarrëse në turne, 16 do të eliminohej pas përfundimit të fazës së

grupeve, ndërsa 32 do ta sigurojnë kalimin në fazën eliminatorë. Deri më tani pesë skuadra që humbën dy ndeshjet e para kanë mbetur pa asnjë mundësi kualifikimi. Listës së të eliminuarve u janë bashkuar edhe Katarit dhe Republika Çeke pas rezultateve të dobëta në grupet e tyre.

Sipas formatit të ri të Kupës së Botës 2026, ekipet që përfundojnë në vendin e katërt të grupit eliminohej automatikisht, ndërsa edhe katër kombëtalet e renditura të tretat me bilancin më të dobët mbeten jashtë fazës së nokautit. Kombëtalet që kanë humbur

matematikisht shanset për kualifikim janë: Haiti, Turqia, Tunizia, Jordania, Panamaja, Katarit dhe Republika Çeke. Ndërkohë, pjesa më e madhe e kombëtareve vazhdojnë garën për një vend në mesin e 32 skuadrave që do të avancojnë në fazën eliminatorë të turneut.



XHAKA SIGURON FAZËN E ELIMINIMIT DIREKT NË BOTËROR ME ZVICRËN



VANCOUVER, 25 QERSHOR - Zvicra ka siguruar vendin e parë në Grupin B të Kupës së Botës, pasi ka mposhtur Kanadanë me rezultat 2:1 në ndeshjen e zhvilluar në Vancouver. Megjithatë, humbja nuk e ka penguar Kanadanë të shkruajë histori, pasi për herë të parë është kualifikuar në fazën eliminatorë të një Kampionati Botëror. Pjesa e parë ka qenë e baraspeshuar, me pak raste të pastra shënimi. Të dy portierët, Gregor Kobel dhe Maxime Crepeau, kanë bërë disa pritje të rëndësishme, duke i mbajtur rjetat e paprekura.

Ndeshja ka marrë një tjetër ritëm menjëherë pas fillimit të pjesës së dytë. Vetëm dyzet sekonda pas rifillimit, Johan Manzambi ka asistuar për Ruben Vargas, i cili ka realizuar për epërsinë 1:0 të zviceranëve. Në minutën e 56 Zvicra e ka dyfishuar rezultatin. Breel Embolo ka përfutur nga një gabim në mbrojtjen kanadeze dhe ka shërbyer për Manzambin, i cili ka shënuar për 2:0. Kanadaja nuk është dorëzuar dhe është hedhur në sulm në kërkim të rikthimit. Trajneri Jesse Marsch ka bërë disa ndryshime, ndërsa njëri prej tyre ka dhënë rezultat të menjëhershëm.

Promise David, i futur në lojë nga banka rezervë, e ka ngushtuar epërsinë në 2:1 pas asistimit nga Nathan Saliba. Në minutat e fundit vendasit kanë ushtruar presion të madh mbi portën zvicerane, por nuk kanë arritur ta gjejnë golin e barazimit. Me këtë fitore, Zvicra e mbyll Grupin B në vendin e parë dhe siguron kalimin në fazën e eliminimit direkt. Nga ana tjetër, Kanadaja e përfundon grupin në pozitën e dytë, para Bosnjë-Hercegovinës falë golaverazhit më të mirë, duke siguruar për herë të parë në histori pjesëmarrjen në fazën eliminatorë të Kupës së Botës.

IOC-ja sjell grant historik: Çdo olimpist mund të përfitojë 10 mijë dollarë

PRISHTINË, 25 QERSHOR - Komiteti Olimpik Ndërkombëtar (IOC) ka njoftuar krijimin e grantit të ri "Fit for the Future Olympian Grant". Sipas një njoftimi të Komitetit Olimpik të Kosovës, përmes këtij granti çdo olimpist do të ketë të drejtë të përfitojë

10 mijë dollarë amerikanë, duke filluar nga Lojërat Olimpikë Dimërore Milano Cortina 2026. "Për herë të parë në histori, të gjithë sportistët pjesëmarrës në Lojërat Olimpikë do ta kenë mundësinë të marrin mbështetje financiare për

zhvillimin e karrierës së tyre sportive ose për tranzicionin drejt karrierës pas sportit", është thënë në njoftimin e Komitetit Olimpik të Kosovës. IOC-ja ka ndarë një fond prej 140 milionë dollarësh për çdo cikël olimpik, nga i cili pritet të

përfitojnë rreth 14 mijë olimpistë. "Ky nuk është shpërblim për medalje. Është njohje për rrugëtimin, përkushtimin dhe sakrificat që duhen për t'u bërë olimpist", ka deklaruar kryetari i Komisionit të Atletëve të IOC-së, Pau Gasol.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

